

# Statistikat afatshkurtra


## Prodhuesit e të mirave - Tremujori III 2018

**Tiranë, më 14 Dhjetor 2018:** Treguesit tremujorë mbi prodhuesit e të mirave, të cilat përfshijnë aktivitetet ekonomike: Industri (Industri Nxjerrëse dhe Industri Përpunuese); Energji elektrike, Gaz, Avull; Furnizimi me ujë, Trajtimi dhe menaxhimi i mbetjeve; Ndërtim, në tremujorin e tretë 2018, paraqiten si më poshtë:

### Industri:

- Indeksi i shitjeve neto në volum shënoi rritje 12,5 %, krahasuar me tremujorin e tretë 2017;
- Indeksi i prodhimit në volum shënoi rritje 7,8 %, krahasuar me tremujorin e tretë 2017;
- Indeksi i numrit të të punësuarve shënoi rritje 9 %, krahasuar me tremujorin e tretë 2017;
- Indeksi i fondit të pagave shënoi rritje 13,3 %, krahasuar me tremujorin e tretë 2017.

Fig. 1 Ndryshimet vjetore të Indeksit të shitjeve neto në volum, Industri (%)




### Energji elektrike, Gaz, Avull

Indekset e treguesve në aktivitetin Energji elektrike, Gaz, Avull, në tremujorin e tretë 2018, paraqiten si më poshtë:

- Indeksi i shitjeve neto në volum shënoi rënje 2,3 %, krahasuar me tremujorin e tretë 2017;
- Indeksi i prodhimit në volum shënoi rritje 58,3 %, krahasuar me tremujorin e tretë 2017;
- Indeksi i numrit të të punësuarve shënoi rritje 5,7 %, krahasuar me tremujorin e tretë 2017;
- Indeksi i fondit të pagave shënoi rritje 4,4 %, krahasuar me tremujorin e tretë 2017.

**Fig. 2 Ndryshimet vjetore të Indeksit të shitjeve neto në volum, Energji elektrike, Gaz, Avull (%)**




### Furnizimi me ujë, Trajtimi dhe menaxhimi i mbetjeve

Indekset e treguesve në aktivitetin Furnizimi me ujë dhe Trajtimi e menaxhimi i mbetjeve, në tremujorin e tretë 2018, paraqiten si më poshtë:

- Indeksi i shitjeve neto në volum shënoi rritje 12,2 %, krahasuar me tremujorin e tretë 2017;
- Indeksi i prodhimit në volum shënoi rritje 12,3 %, krahasuar me tremujorin e tretë 2017;
- Indeksi i numrit të të punësuarve shënoi rritje 6,4 %, krahasuar me tremujorin e tretë 2017;
- Indeksi i fondit të pagave shënoi rritje 7,1 %, krahasuar me tremujorin e tretë 2017.

**Fig. 3 Ndryshimet vjetore të Indeksit të shitjeve neto në volum, Furnizimin me ujë, Trajtimi e menaxhimi i mbetjeve (%)**




#### Ndërtim

Indekset e treguesve në aktivitetin Ndërtim, në tremujorin e tretë 2018, paraqiten si më poshtë:

- Indeksi i shitjeve neto në volum shënoi rritje 9,5 %, krahasuar me tremujorin e tretë 2017;
- Indeksi i prodhimit në volum shënoi rritje 12 %, krahasuar me tremujorin e tretë 2017;
- Indeksi i numrit të punësuarve shënoi rritje 2,2 %, krahasuar me tremujorin e tretë 2017;
- Indeksi i fondit të pagave shënoi rritje 3,6 %, krahasuar me tremujorin e tretë 2017.

**Fig. 4 Ndryshimet vjetore të Indeksit të shitjeve neto, Ndërtim (%)**



**Tab. 1 Indeksi i shitjeve neto në volum, prodhuesit e të mirave**

Sekcioni	Ndarja	Aktiviteti ekonomik	Pa përshtatje sezonale		Me përshtatje sezonale	
			Tr.III 2018 (2010=100)	III.18 / III.17 (%)	Tr.III 2018 (2010=100)	III.18 / II.18 (%)
B-C	05-33	<b>Industri</b>	129,5	12,5	123,1	-2,0
B	05-09	<i>Industri nxjerrëse</i>	141,3	6,9	136,0	-9,0
C	10-33	<i>Industri përpunuese</i>	136,8	13,0	129,2	-0,9
D	35	Energji elektrike, Gaz, Avull	159,9	-2,3	173,3	-17,8
E	36-39	Grumbullimi, trajtimi dhe furnizimi me ujë	191,1	12,2	189,4	1,1
F	41-43	<b>Ndërtim</b>	127,4	9,5	132,2	9,5
<b>Grupimet industriale kryesore</b>						
		Mallra të ndërmjetme	149,6	14,2	143,8	-3,4
		Energji	115,6	-0,7	119,0	-18,6
		Mallra kapitale	194,2	20,1	187,8	-2,8
		Mallra të qëndrueshme konsumi	122,9	-8,3	114,1	-16,6
		Mallra të paqëndrueshme konsumi	151,1	11,3	138,3	-0,9

**Tab. 2 Indeksi i prodhimit në volum, prodhuesit e të mirave**

Sekcioni	Ndarja	Aktiviteti ekonomik	Pa përshtatje sezonale		Me përshtatje sezonale	
			Tr.III 2018 (2010=100)	III.18 / III.17 (%)	Tr.III 2018 (2010=100)	III.18 / II.18 (%)
B-C	05-33	<b>Industri</b>	156,0	7,8	146,8	-14,3
B	05-09	<i>Industri nxjerrëse</i>	158,9	7,1	144,7	-30,1
C	10-33	<i>Industri përpunuese</i>	143,8	8,1	130,1	-1,9
D	35	Energji elektrike, Gaz, Avull	122,7	58,3	156,6	-30,5
E	36-39	Grumbullimi, trajtimi dhe furnizimi me ujë	130,3	12,3	127,4	-15,4
F	41-43	<b>Ndërtim</b>	130,4	12,0	135,6	12,7
<b>Grupimet industriale kryesore</b>						
		Mallra të ndërmjetme	199,0	3,4	185,5	-13,6
		Energji	137,2	35,8	145,9	-36,5
		Mallra kapitale	515,0	29,9	508,0	3,3
		Mallra të qëndrueshme konsumi	95,1	2,6	88,9	-13,9
		Mallra të paqëndrueshme konsumi	146,0	8,9	136,7	-2,1

**Tab. 3 Indeksi i numrit të të punësuarve dhe fondit të pagave, prodhuesit e të mirave**

Sekcioni	Ndarja	Aktiviteti ekonomik	Numri i të të punësuarve		Fondi i pagave	
			Tr.III 2018 (2010=100)	III.18 / III.17 (%)	Tr.III 2018 (2010=100)	III.18 / III.17 (%)
B-C	05-33	Industri	153,6	9,0	199,2	13,3
B	05-09	Industri nxjerrëse	107,2	7,3	199,0	11,6
C	10-33	Industri përpunuese	161,8	9,1	195,5	13,3
D	35	Energji elektrike, Gaz, Avull	128,7	5,7	203,6	4,4
E	36-39	Grumbullimi, trajtimi dhe furnizimi me ujë	165,8	6,4	202,8	7,1
F	41-43	Ndërtim	130,0	2,2	166,3	3,6

# Shënime metodologjike

## Informacion mbi vrojtimin

**Qëllimi** - Statistikat afatshkurtra paraqesin ecurinë e ekonomisë së vendit në periudha tremujore, nëpërmjet të cilave kuptohet zhvillimi i ciklit të ekonomisë si dhe mund të bëhen parashikime për të ardhmen e afërt. Vrojtimi tremujor ka për qëllim të paraqesë ecurinë e treguesve kryesorë ekonomikë të ndërmarrjeve ekonomike në periudha tremujore.

### Në prodhuesit e të mirave:

**Fusha e mbulimit** - Bazuar në aktivitetin kryesor, në anketën tremujore pranë ndërmarrjeve janë përfshirë ndërmarrjet që kryejnë këto aktivitete:

- Industri, e cila përbëhet nga Industria Nxjerrëse dhe Përpunuese (05 – 33)
- Energji elektrike, gaz, avull (35)
- Furnizimi me ujë, trajtimi dhe menaxhimi i mbetjeve (36-39)
- Ndërtim (41, 42, 43)

**Modeli** - Kampioni i ndërmarrjeve është zgjedhur nga Regjistri Statistikor i Ndërmarrjeve, ku kampioni për ndërmarrjet me 1-9 të punësuar është marrë me zgjedhje, ndërsa ndërmarrjet me 10 e më shumë të punësuar janë anketuar tërësisht.

**Mbledhja e informacionit** - Mbledhja e të dhënave bëhet me intervistim të drejtpërdrejtë nga anketuesit, të cilët plotësojnë anketën tremujore në bazë të deklarimeve që bën personi përgjegjës i ndërmarrjes për plotësimin e kësaj ankete.

**Treguesit** - Janë dhënë në formë indeksi, ndryshimi vjetor në përqindje, ndryshimi tremujor në përqindje me vit referues bazë, aktualisht  $2010=100$ . Të dhënrat nuk paraqesin vlera absolute.

**Indekset** - Shprehin ndryshimin në kohë të një variabli të dhënë ose tërësi variablash. Indeksi i volumit është llogaritur me anë të formulës Laspeyres. Për të eleminuar ndikimin e çmimeve, indekset deflatohen me indekset përkatëse të çmimeve, si: Indeksi i Çmimeve të Prodhimit për aktivitetin industrial dhe Tregtinë me Shumicë, Indeksi i Kostos në Ndërtim për aktivitetin ndërtimor.

**Ndryshimi vjetor në përqindje** - Mat ndryshimin në përqindje të treguesit ekonomik të tremujorit aktual ndaj tremujorit të njëjtë të një viti më parë.

**Ndryshimi tremujor në përqindje** - Mat ndryshimin në përqindje të treguesit ekonomik të tremujorit aktual ndaj tremujorit paraardhës të të njëjtit vit.

**Rishikimi** – Indekset mund të rishikohen për disa arsyet: Informacion shtesë, ndryshime metodologjike ose rivlersime të koeficientëve të përdorur, etj.

### Përkufizimet e treguesve kryesorë

*Shitjet neto* - *Shitjet neto* përfshijnë shumat e faturuara për të gjithë aktivitetin e kryer nga njësia që vrojtohet për periudhën referuese dhe kjo korespondon me tregun e shitjes së mallrave dhe shërbimeve të tretëve, duke përashtuar taksën mbi vlerën e shtuar.

*Indeksi i shitjeve neto* - Objktivi i indeksit të *shitjeve neto* është të paraqesë ecurinë e tregut për mallra dhe shërbime.

*Numri i të punësuarve me pagesë* - Numri gjithsej i personave të punësuar me pagesë në njësinë e vrojtuar (përashtuar të vetëpunësuarit me pagesë).

*Paga dhe trajtime* - Ajo përfshin fondin e pagave dhe shpërbllimet e trajtimet (në vlerë monetare apo natyrë - të vlerësuar në lekë) paguar të gjithë të punësuarve, në këmbim të punës së kryer gjatë periudhës referuese.

*Indeksi i fondit të pagave* - Indeksi i fondit të pagës paraqet në mënyrë të përafërt ecurinë e fondit të pagave, në njësinë e vrojtuar, nga njëra periudhë në tjeter.

**Grupimet Industriale Kryesore** janë një rigrupim i aktiviteteve Industri Nxjerrëse, Industri Përpunuese dhe Energji të detajuara sipas Nomenklaturës së Veprimitarive Ekonomike (NVE Rev.2), si më poshtë:

Grupimet Industriale Kryesore	NVE Rev.2
Mallra të ndërmjetme	<ul style="list-style-type: none"> <li>• 07-09 Nxjerra e minraleve natyrore; Nxjerra e minraleve të tjera nga minierat; Aktivitete mbështetëse minerare</li> <li>• 13000 Përpunimi i tekstileve</li> <li>• 16000 Prodhimi i drurit dhe materialeve prej druri, përvèç mobiljeve</li> <li>• 17000 Prodhimi i letrës dhe produkteve prej letre</li> <li>• 20-21 Prodhimi i kimikateve dhe produkteve kimike; Përpunimi i produkteve farmaceutike</li> <li>• 22000 Prodhimi i produkteve të kauçukut dhe plastikës</li> <li>• 23000 Prodhimi i produkteve minerale jo metalike</li> <li>• 24000 Metalurgjia</li> <li>• 255XX Farkëtimi, stampimi, petëzimi dhe trafilizimi i metaleve</li> <li>• 27000 Prodhimi i pajisjeve elektrike</li> </ul>
Energji	<ul style="list-style-type: none"> <li>• 05-06 Nxjerra e qymyrit dhe linjiteve; Nxjerra e naftës bruto dhe gazit natyror</li> <li>• 19000 Përpunimi i koksit dhe rafineria e nënprodukteve të naftës</li> <li>• 35000 Energjia elektrike, gazi, avulli dhe ajri i kondicionuar</li> </ul>
Mallra kapitale	<ul style="list-style-type: none"> <li>• 251XX Prodhimi i produkteve metalike strukturore</li> <li>• 262XX Prodhimi i kompjuterave dhe pajisjeve periferike</li> <li>• 28000 Prodhimi i makinerive dhe pajisjeve p.k.t</li> <li>• 33000 Riparimi dhe instalimi i makinerive dhe pajisjeve</li> </ul>
Mallra të qëndrueshme konsumi	<ul style="list-style-type: none"> <li>• 264XX Prodhimi i produkteve elektronike për konsumatorët</li> <li>• 31000 Prodhimi i mobiljeve</li> <li>• 32XXX Industri të tjera p.k.t</li> </ul>
Mallra të paqëndrueshme konsumi	<ul style="list-style-type: none"> <li>• 10000 Përpunimi i produkteve ushqimore</li> <li>• 11-12 Prodhimi i pijeve; Prodhimi i produkteve të duhanit</li> <li>• 14000 Konfektionimi i veshjeve</li> <li>• 15000 Prodhimi i lëkures dhe produkteve prej lëkure</li> <li>• 18000 Shtypshkrimi dhe rigrupimi i mediave të regjistruara</li> <li>• 32YYY Industri të tjera p.k.t</li> </ul>

**Përshtatja sezonale**

Përshtatja sezonale në seritë tremujore të prodhimit të të mirave materiale u zbatua duke përdorur si software JDemetra+, versioni 2.1.0. Model i përzgjedhur për shpërbërjen e serive është X-12 Arima, nënspecifikimin X-13 në serinë kohore Tremujori I 2005 - Tremujori III 2018. Modeli X-12 Arima bazohet plotësisht mbi mesataren e lëvizëshme. Në seritë e të dhënave është zbatuar shpërbërja e shumëfishtë (multiplikative). Përshtatjet janë në drejtim të ndikimeve sezonale në pasqyrimin e statistikave afatshkurtra. Për përshtatjet sezonale të serive është përdorur qasja direkte. Në përshtatjen sezonale janë analizuar edhe ngjarjet e veçanta të ndodhura përgjatë harkut kohor të shtrirjes së serive.